



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.09.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2643/22, për zyrtarët: z. Flamur Fetahaj, Nënkyetar i Komunës së Gjakovës, z. Lon Ibishi, Zyrtar në Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Gjakovës dhe z. Burim Bajrami, Udhëheqës i Sektorit për punë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarët z. Flamur Fetahaj, Nënkyetar i Komunës së Gjakovës, z. Lon Ibishi, Zyrtar në Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Gjakovës dhe z. Burim Bajrami, Udhëheqës i Sektorit për punë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatës nga raportuesi anonim, ka filluar trajtimin e këtij rasti me pretendimin për konflikt të interesit në rastin e z. Lon Ibishi dhe z. Burim Bajrami, të cilët si zyrtarë të Komunës së Gjakovës, njëkohësisht janë emëruar edhe si anëtar të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A., - Gjakovë, e të cilët janë vartës direkt të nënkryetarit të komunës z. Flamur Fetahaj, i cili është edhe kryesues i Komisionit të Aksionarëve të ndërmarrjes në fjalë.

Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka njoftuar zyrtarët e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit si dhe me pretendimet lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, dispozitave ligjore përkatëse si dhe sqarimeve nga palët, Agjencia ka gjetur se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit, ashtu siç përcakton neni 6 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, respektivisht: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.”*

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Komisioni i Aksionarëve nuk është organ drejtues, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 13 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, andaj edhe kufizimet e dispozitës në fjalë nuk vlejnë në rastin konkret.

Gjithashtu, sa i përket kryesuesit të Komisionit të Aksionarëve z. Fetahaj, me Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar/plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe Ligjin Nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (tutje: Ligji për Ndërmarrjet Publike), te ushtrimi i të drejtave të aksionarit është përcaktuar se:

“Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar”(neni 5, paragrafi2).

Rrjedhimisht, z. Fetahaj është emëruar në Komisionin Komunal të Aksionarëve nga ana e kryetarit të Komunës, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Sa i përket z. Lon Ibishi dhe z. Burim Bajrami, të cilët si zyrtar (jo zyrtarë të lartë) në Komunën Gjakovës, njëkohësisht janë zgjedhur dhe ushtrojnë funksioni e anëtarit të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Gjakovë, me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk është përcaktuar ndonjë kufizim përkitazi me mbajtjen e njëkohshme të pozitave në fjalë.


Lidhur me pretendimin e raportuesit të rasti, se me rastin e përzgjedhjes së anëtareve të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Gjakovë, nuk është përfillur kushti gjinor, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit thekson se nuk është kompetente për hetimin dhe trajtimin e pretendimit në fjalë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit në lidhje me nenin 29 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për Parandalimin Korrupsionit

